REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA E FINANCËS,PLANIFIKIMIT TË BUXHETIT DHE MENAXHIMIT TË ASETEVE

Nr.7869 Prot Himarë, më 21.10.2026

Lënda: Dërgohet për shqyrtim dhe miratim relacioni dhe projektvendimi "Për miratimin e një ndryshimi në buxhetin e vitit 2026 të Bashkisë Himarë për mbështetjen financiare të organizatave jofitimprurëse për zbatimin e programit "Shërbimi Lëvizës""

KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË
Sekretarit të këshillit Z. Zaho Dedi

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 54, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjit nr. 10296/2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, ligjit nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimit nr. 23/2018 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm në njësitë e pushtetit vendor", i ndryshuar, VKB nr. 61, datë 22.12.2025 "Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe kalendarit të përgatitjes së PBA 2027-2029 dhe buxheti vjetor 2027", VKB nr. 32, datë 30.06.2026 "Për miratimin e disa ndryshimeve buxhetore mbi buxhetin e vitit 2026", VKB nr. 51, datë 30.09.2026 për ndryshimet e shtatorit, po ju dërgojmë relacionin dhe projektvendimin "Për miratimin e një ndryshimi në buxhetin e vitit 2026 të Bashkisë Himarë për mbështetjen financiare të organizatave jofitimprurëse për zbatimin e programit "Shërbimi Lëvizës"".

Faleminderit për bashkëpunimin.

K R Y E T A R
Vangjel Tavo

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSKRYETARI
Erfili Berberi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA HIMARË

Adresa: Rr. "25 Marsi", nr.2; Spile, Himarë,; e-mail: info@himara.gov.al ; WEB:www.himara.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA E FINANCËS,PLANIFIKIMIT TË BUXHETIT DHE MENAXHIMIT TË ASETEVE

Nr 7869/1 Prot

Himarë, më 21.10.2026

PROJEKTVENDIM
NR. 65 DATË. 21.10. /2026

"PËR MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË BUXHETIN E VITIT 2026 TË BASHKISË HIMARË PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE TË ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT "SHËRBIMI LËVIZËS""

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 54, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjit nr. 10296/2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, ligjit nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimit nr. 23/2018 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm në njësitë e pushtetit vendor", i ndryshuar, VKB nr. 61, datë 22.12.2025 "Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe kalendarit të përgatitjes së PBA 2027-2029 dhe buxheti vjetor 2027", VKB nr. 32, datë 30.06.2026 "Për miratimin e disa ndryshimeve buxhetore mbi buxhetin e vitit 2026", VKB nr. 51, datë 30.09.2026 për ndryshimet e shtatorit, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak Himarë

VENDOSI:

1. Të miratohet pakësimi me 461,160 lekë i fondit në programin buxhetor 09120 "Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor", kapitulli 05 (të ardhurat e veta), llogaria ekonomike 602 "Mallra dhe shërbime", nga 1,461,160 lekë në 1,000,000 lekë.
2. Të miratohet krijimi i zërit të ri buxhetor "Mbështetje financiare për OJF për zbatimin e programit "Shërbimi Lëvizës"" në programin buxhetor 10430 "Përkujdesja sociale", kapitulli 05, llogaria ekonomike 604 "Transferta korrente të brendshme", në vlerën 461,160 lekë.
3. Fondi prej 461,160 lekë të përdoret për sigurimin e pakove ushqimore për familjet dhe individët në nevojë dhe të medikamenteve e materialeve të nevojshme për përfituesit e Shërbimit Lëvizës Social, nëpërmjet organizatës jofitimprurëse të përzgjedhur sipas Njoftimit nr. 7771 prot., datë 19.10.2026.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e financës, planifikimit të buxhetit dhe menaxhimit të aseteve dhe Drejtoria e Çështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë.
   Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Vangjel Tavo

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSKRYETARI
Erfili Berberi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA E FINANCËS,PLANIFIKIMIT TË BUXHETIT DHE MENAXHIMIT TË ASETEVE

Nr.1869/2 Prot

Himarë, më 21.10.2026

RELACION

"PËR MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË BUXHETIN E VITIT 2026 TË BASHKISË HIMARË PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE TË ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT "SHËRBIMI LËVIZËS""

Informacion i përgjithshëm mbi buxhetin e bashkisë për vitin 2026 dhe ndryshimet

Në bazë te ligj Nr.9936, datë 26.6.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjin nr. 139/2015 neni 16 pika, ligjit Nr. 68, datë 27.04.2017 "Per financat e vetëqeverisjen vendore", Bashkia Himarë vlerëson të ardhurat e realizuara deri në këtë periudhë si dhe faktorët e tjerë makroekonomik të publikuara nga institucionet përkatëse. Gjithashtu bazuar në nevojat dhe prioritetet e komunitetit si dhe politikat zhvillimore, bën shpërndarjen e të ardhurave shtesë ose rialokimeve të ndryshme për shkak të faktorëve ndikues gjatë kësaj periudhe. Disa nga faktorët kryesorë të cilët çojnë në nevojshmërinë e këtyre ndryshimeve buxhetore janë:

a) Fondi i papërdorur në programin buxhetor 09120.

Sipas shpërndarjes së buxhetit të vitit 2026 (Qershor 2026, e ndryshuar në shtator), në programin buxhetor 09120 "Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor", kapitulli 05 (të ardhurat e veta), llogaria ekonomike 602 "Mallra dhe shërbime", janë planifikuar gjithsej 1,461,160 lekë, nga të cilat 1,000,000 lekë në muajin mars dhe 461,160 lekë në muajin qershor. Fondi prej 461,160 lekë i planifikuar për muajin qershor nuk është angazhuar dhe nuk është shpenzuar deri në këtë periudhë, prandaj propozohet që të rialokohet në një zë tjetër me prioritet për komunitetin.

b) Nevoja për fond për programin "Shërbimi Lëvizës".

Në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit nr. 1446, datë 11.02.2026, ndërmjet Shërbimit Social Shtetëror dhe Bashkisë Himarë për financimin e Programit të Shërbimit Lëvizës Social, Bashkia ka evidentuar nevojën për sigurimin e pakove ushqimore për familjet dhe individët përfitues të programit, si dhe të medikamenteve dhe materialeve të nevojshme për përfituesit e Shërbimit Lëvizës Social. Këto shërbime mund të ofrohen nëpërmjet organizatave

jofitimprurëse, me qëllim garantimin e vazhdimësisë së shërbimeve sociale për grupet në nevojë.

c) Njoftimi për shprehje interesi nga OJF-të.

Bashkia Himarë ka publikuar Njoftimin nr. 7771 prot., datë 19.10.2026 "Për shprehje interesi nga organizatat jofitimprurëse (OJF) për zbatimin e programit "Shërbimi Lëvizës"", me afat dorëzimi deri më 13.11.2026. Programi synon ofrimin e shërbimeve sociale drejtpërdrejt në komunitet për familjet dhe individët në nevojë ekonomike e sociale, fëmijët dhe të rinjtë në situata vulnerabiliteti, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, gratë dhe vajzat në situata rreziku ose të prekura nga dhuna në familje, si dhe kategori të tjera në nevojë.

d) Krijimi i zërit të ri buxhetor.

Për financimin e OJF-së që do të përzgjidhet, propozohet krijimi i një zëri të ri në programin buxhetor 10430 "Përkujdesja sociale", kapitulli 05 (të ardhurat e veta), llogaria ekonomike 604 "Transferta korrente të brendshme", me emërtimin "Mbështetje financiare për OJF për zbatimin e programit "Shërbimi Lëvizës"", në vlerën 461,160 lekë. Fondi do t'i kalojë OJF-së së përzgjedhur vetëm pas lidhjes së marrëveshjes së bashkëpunimit dhe do të justifikohet me dokumente për përfituesit dhe shpenzimet e kryera, në përputhje me ligjin nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë".

Efekti në buxhetin e vitit 2026 të Bashkisë Himarë

Ndryshimi i propozuar nuk prek të ardhurat e bashkisë dhe nuk ndryshon totalin e buxhetit të vitit 2026. Është një rialokim prej 461,160 lekë ndërmjet dy programeve buxhetore, brenda kapitullit 05 (të ardhurat e veta), nga llogaria ekonomike 602 te llogaria ekonomike 604.

Meqenëse fondi kalon nga një program buxhetor në një tjetër, ndryshimi kërkon shqyrtimin dhe miratimin e Këshillit Bashkiak, në përputhje me ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" dhe ligjin nr. 9936/2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Për sa më sipër ndryshimi pasqyrohet në formë tabelare dhe shoqërohet me shpjegimet përkatëse.

			Emertimi i projektit ose i objektit	***ISHTE***	***BEHET***

NR	Kod prog	Llog ekon			
1	*09120*	*602*	Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor, kapitulli 05 (të ardhurat e veta)	1,461,160.00	1,000,000.00
2	*10430*	*604*	Mbështetje financiare për OJF për zbatimin e programit "Shërbimi Lëvizës", kapitulli 05	0.00	461,160.00

Tabela tregon ndryshimin që propozohet. Te programi buxhetor 09120, llogaria ekonomike 602, kapitulli 05 (të ardhurat e veta), fondi pakësohet me 461,160 lekë, nga 1,461,160 lekë në 1,000,000 lekë. Te programi buxhetor 10430, llogaria ekonomike 604, kapitulli 05, krijohet zëri i ri buxhetor "Mbështetje financiare për OJF për zbatimin e programit "Shërbimi Lëvizës"", me fond 461,160 lekë.

Pas këtij ndryshimi, totali i llogarisë 602 në buxhetin e bashkisë ndryshon nga 361,909,781 lekë në 361,448,621 lekë, ndërsa totali i llogarisë 604 ndryshon nga 175,141,000 lekë në 175,602,160 lekë. Totali i shpenzimeve dhe i të ardhurave mbetet i pandryshuar.

Fondi do të angazhohet vetëm pas miratimit të këtij vendimi dhe brenda kufirit të miratuar, në përputhje me ligjin nr. 10296/2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.

Bazuar sa më sipër, i propozojmë Këshillit Bashkiak Himarë shqyrtimin dhe miratimin e ndryshimit të mësipërm në buxhetin e vitit 2026.

DREJTORI

Besa Xhaferi